



NEWSLETTER

Korrik 2025

Nr.7

Është konstituar Këshilli i ri i ASHMA-së



Anëtarët e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, të emëruar nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut më 24 qershor 2025, më 3 korrik 2025 mbajtën një seancë konstituive. Në seancë, në përputhje me Ligjin për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele dhe Rregulloren e Punës së Agjencisë, u zgjodhën kryetar dhe zëvendëskryetar. Për kryetar u zgjodh Sasho Stefanovski, ndërsa për zëvendëskryetare u zgjodh Zirjeta Hajro Jajaga.

Në Këshillin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele përveç Sasho Stefanovskit dhe Zirjeta Hajro Jajagës, janë edhe si anëtarë Gordana Majnova, Petar Xhurovski, Afrona Vërzivolli, Cvetanka Minovska dhe Viktor Pavlovski.

Njoftim publik

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele më 9 korrik përmes njoftimi publik dënon ashpë sulmin fizik ndaj ekipit të gazetarëve të televizionit Alsat-M, i cili po dokumentonte zjarrin në deponinë e Vizbegovës. Në njoftim është theksuar se siguria e gazetarëve paraqet parakusht thelbësor për raportim profesional dhe të pavarur, i cili është themeli i të drejtës së qytetarëve për t'u informuar saktë, në kohë dhe objektivisht.

Është thelbësore që gazetarët të kenë mundësinë të kryejnë lirisht dhe në mënyrë të sigurt detyrat e tyre profesionale në interes të publikut, dhe dhuna ndaj punonjësve të medias, në çdo formë, është absolutisht e papranueshme dhe duhet të sanksionohet qartë.

Debat i hapur publik mbi Draft-Udhëzimin për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele më 7 korrik hapi një debat publik për [Draft-udhëzimin për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës](#).

Ndryshimi dhe plotësimi i Udhëzimit buron nga ndryshimet në Ligjin për Shërbimet Mediatike Audio dhe Audiovizuele të vitit 2023 dhe ndryshimet në Ligjin për Median të vitit 2025. Qëllimi i këtyre ndryshimeve është në Udhëzim të përcaktohen afate për veprimin sipas masave paralajmërim publik për subjektet e reja (mediat online - portalet e internetit dhe ofruesit e shërbimeve platformë të ndarjes së videove). Janë shtuar dhe afate për dispozitat e reja të LSHMAAV për sigurimin e qasjes në përmbajtje për personat me aftësi të kufizuara dhe për mbrojtjen e të dhënave personale të të miturve, dhe është propozuar të harmonizohet kohëzgjatja e afateve për të gjitha subjektet.

Agjencia u bëri thirrje mediave online - portaleve të internetit, ofruesve të shërbimeve platformë të ndarjes së videove, operatorëve të rrjeteve publike të komunikimit elektronik, transmetuesve dhe palëve të interesuara me mendimet dhe propozimet e tyre të marrin pjesë në debatin publik dhe t'i paraqesin ato me shkrim në mënyrë elektronike në adresën e email-it: contact@avmu.mk. Debati publik do të zgjasë 60 ditë, deri më 4 shtator 2025.

Debat i hapur publik mbi Draft-Rregulloren e Punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele

Këshilli i Agjencisë, në seancën e 5-të mbajtur më 21 korrik, miratoi [Draft-Rregulloren e Punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele](#).

Agjencia ftoi të gjitha palët e interesuara me mendimet dhe propozimet e tyre të marrin pjesë në debatin publik për Draft-Rregulloren e Punës dhe t'i paraqesin ato me shkrim në mënyrë elektronike në adresën e email-it: contact@avmu.mk. Debati publik do të zgjasë 30 ditë, deri më 20 gusht 2025.

Debat i hapur publik mbi Draft-Udhëzimin për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit për konfirmimin e raporteve për transmetim të reklamave politike me pagesë

Këshilli i Agjencisë, në seancën e 5-të mbajtur më 21 korrik, miratoi [Draft-Udhëzimin për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit për konfirmimin e raporteve për transmetim të reklamave politike me pagesë](#).

Agjencia ftoi të gjitha palët e interesuara me mendimet dhe propozimet e tyre të marrin pjesë në debatin publik për Draft-Udhëzimin dhe t'i paraqesin ato me shkrim në mënyrë elektronike në adresën e email-it: contact@avmu.mk. Debati publik do të zgjasë 45 ditë, deri më 5 shtator 2025.



NEWSLETTER

Mbikëqyrja e transmetuesve dhe operatorëve të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike

Transmetuesit

Mbikëqyrja e rregullt programore dhe administrative për disa detyrime ligjore - respektimi i rregullave gjatë transmetimit të komunikimeve komerciale audiovizuale, ofrimi i kuizeve ose formave të tjera të pjesëmarrjes në çmime, shfrytëzimi i shërbimeve telefonike me vlerë të shtuar dhe votimi telefonik, transmetimi i lojërave të fatit, respektimi i detyrimeve për përdorimin e gjuhës në program, për transmetim së paku 18 orë në ditë të programeve në radio, publikim impresium, informacioni që duhet t'u vihet në dispozicion përdoruesve dhe për detyrimin për të publikuar identifikimin e transmetuesit është kryer mbi radiot Metropolis, Jon, Antena 5 dhe Kanal 77. Gjatë mbikëqyrjes nuk u konstatuan shkelje të Ligjit për Median dhe LSHMAAV.

Operatorët e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike

Agjencia ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore mbi operatorët Datakom JV, Skupi Kable, A1 Makedonija, Makedonski Telekom dhe Nafi dhe Beko për detyrimin në paketën programore që e ritransmetojnë detyrimisht dhe pa pagesë për të ofruar shërbimet programore të shërbimit publik radiodifuziv, si dhe për detyrimet për regjistrimin e shërbimeve programore në Agjenci dhe titrimin e programeve që ata ritransmetojnë. Gjatë mbikëqyrjes nuk u konstatuan shkelje të dispozitave të LSHMAAV.

Është kryer dhe mbikëqyrje e kontrollit programor ndaj operatorit Total TV me qëllim përcaktimin nëse ka vepruar sipas Aktvendimit për paralajmërim publik dhe për përjashtimin e ritransmetimit të shërbimeve programore brenda afatit të përcaktuar, përkatësisht nëse shërbimet programore që ritransmeton janë të regjistruara në Agjenci në përputhje me nenin 141 të LSHMAAV. Mbikëqyrja kontrollit mbi TOTAL TV tregoi se operatori ka vepruar në përputhje të plotë me aktvendimin.

Masat e shqiptuara paralajmërim publik

Në bazë të konstatimeve nga mbikëqyrjet e kryera, Këshilli i Agjencisë, në seancën e dytë të mbajtur më 7 korrik, miratoi tre aktvendime për shqiptimin e masës paralajmërim publik. Paralajmërim publik u shqiptua ndaj operatorit Altra-Sat 2000 nga Ohri, për shkak të ritransmetimit të shërbimeve programore që nuk janë të mbuluara nga çertifikata e regjistrimit e lëshuar nga Agjencia. Për shkak të mosrespektimit të detyrimit ligjor për mbrojtjen e të miturve, përkatësisht aplikimit të shenjave paralajmëruese për programet e kategorisë së dytë, u shqiptuan masa paralajmërim publik ndaj TV M dhe TV Studio Tera.

Këshilli i Agjencisë, në seancën e pestë të mbajtur më 21 korrik, në bazë të konstatimeve nga mbikëqyrja e kryer ka shqiptuar masa paralajmërim publik TV Kanal Festa dhe TV Plus. Për dy televizionet paralajmërim publik iu shqiptuan sepse, më 3 qershor 2025, nuk transmetuan së paku 30% program të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase, as nuk transmetuan së paku gjysmën e minimumit ligjor në periudhën nga ora 7:00 deri në 19:00.

Këshilli i Agjencisë, në seancën e gjashtë të mbajtur më 29 korrik, për shkak të mosrespektimit të dispozitave të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale ka shqiptuar masa paralajmërimi publik për TV Uskana Media dhe TV Kanal Festa. Masë paralajmërim publik ndaj TV Festa është shqiptuar për mosdhënien e informacionit që duhet t'u vihet në dispozicion përdoruesve, ndërsa TV Uskana Media për mostransmetim së paku 30% program të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase dhe për transmetimin e reklamave në gjuhën angleze pa ofruar përkthimin në gjuhët në të cilat media transmeton programe në përputhje me lejen.

